



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më 16.04.2026

Procesverbal -Tipi i kontrates - Sherbim

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS -“Sherbimi i transportit të nxenesve në kuadër të pjesëmarrjes në programin TUMO TIRANA”

LLOJI PROCEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar – sherbim”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT
(CPV): 60000000-8- Sherbime të transportit**

VLERA E FONDIT LIMIT - 2,426,666 (dymilion e katerqind e njetzet e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2026.

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si mëposhte:

Shtojca 9.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajnë listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteri (1- a) është vendosur ne baze. bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ne piken 1 te nenit 82 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar percaktohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kriteri (1-b) është vendosur bazuar ne nenin 83 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenin 30 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ne piken 1 te nenit 83 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe piken 1 te nenit 30 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar percaktohet: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9;

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të paraqese një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të percaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP; ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar; të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise”, i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5. Vendosja e ketij kriteri

kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar qe operatorët ekonomikë nuk kane pagesa te pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

Ne nenin 76, pika 2 të LPP parashikohet: Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Në nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia.

Ne nenin 2, germa ç, te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise”, i ndryshuar, parashikohet: Ky ligj zbatohet për:

ç) sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

Ne nenin 4, pika 1 dhe 3, te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Tatimet dhe taksat janë kombëtare ose vendore.

3. Tatimet dhe taksat vendore përcaktohen në ligjin për sistemin e taksave vendore.

Ne neni 43 te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Tatimpaguesi, person fizik dhe juridik, regjistron çdo ndryshim të të dhënave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, siç përcaktohet në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia.

1/2. Edhe personi fizik tregtar i pajisur me NIPT/NUIS, për çdo veprimtari të re që kërkontë regjistrojë, pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes të veprimtarisë së re

Ne nenin 5 te ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nder te tjera parashikohet: Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak:

- a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesatvëndorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;
- b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori nënkategori të bazës së taksës;
- c) përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore përgjate tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP, nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; si dhe ligjin nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Ne nenin 61 të Ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" parashikohet:

1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjithatë ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.

2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.

Ne nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nder te tjera parashikohet:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Gjithashtu është kërkuar që vlera minimale e xhiros vjetore për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë, duke qene se lloji i procedurës është e hapur e thjeshtuar, të jete jo më vogël se 40 % e fondit limit.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave shërbimeve të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, me një vlerë **jo më të vogël se 20%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë Operatore Ekonomik duhet të paraqesin:

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes dhe të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Në nenin 77 pika 4 i LPP, ndër të tjera parashikohet se: Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Në nenin 41, pika 3 parashikohet se: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në nenin 55 "Procedura e hapur e thjeshtuar", pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet se: Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Sa me sipër është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit të jenë minimalisht në vlerën 20 % të vlerës së fondit limit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë për transport udhëtarësh lëshuar nga autoritetet kompetente (ministra/bashkia, sipas rastit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; nenit 41, pika 4/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar; ligjin 8308, datë 18.03.1998 "Per transportet rrugore", i ndryshuar; Udhezimin e ministrit të Transportit dhe Infrastruktues nr.5627 datë 18.11.2016 "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE BRENDË VENDIT", i ndryshuar; VKM nr. 89, datë 14.02.2018 "Per miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxenesve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studenteve". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kryejnë veprimtarinë, objekt prokurimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi duke garantuar AK në zbatimin e kontratës.

Ne nenin 77 të LPP ndër të tjera parashikohet: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Ne nenin 41 pika 4/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Ne nenin 3 të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, i ndryshuar, pikat 3.5, 3.10, 3.11 dhe 3.17 përcaktohet se:

3.5. **Autobus:** mjet motorik i prodhuar vetëm për transportin e udhëtarëve me më shumë e 8 vende të ulura, përveç atij të drejtuesit të automjetit.

3.10. Transport i rregullt udhëtarësh është shërbim i rregullt transporti në itinerare dhe vendqëndrime të pandryshuara, të ofruara nga transportuesi dhe të përcaktuara më parë në rregulloren e udhëtimit. Ky shërbim mund të jetë qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, ndërkombëtar dhe shërbim i rregullt, i specializuar.

3.11. **Transport i rastit i udhëtarëve** nënkupton shërbimet që nuk përfshihen në shërbimet e rregullta brenda vendit ose ato ndërkombëtare, të përkufizuara në pikën 3.10 të nenit 3, të cilat kryhen në itinerarin, me çmimin, shkallën e shërbimit dhe kushtet e tjera, që përcaktohen në marrëveshjen ndërmjet transportuesit dhe përdoruesit.

3.17. **Licencë:** e drejta për të kryer veprimtari transporti të rregullt udhëtarësh dhe veprimtari transporti mallrash për të tretë e me qira brenda dhe jashtë vendit në përputhje me këtë ligj.

Ne nenin 5 të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licences.

Ne nenin 12 të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

Transporti i udhëtarëve brenda vendit kryhet nëpërmjet:

- a) shërbimeve në linja të rregullta, transporti qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës;
- b) shërbimeve të rregullta, të specializuara;
- c) transporteve për llogari të vet;

ç) transporteve të rastit.

Ne nenin 25 të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

Transportet e rastit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.11 të nenit 3, janë objekt i këtij ligji.

Ne nenin 26 të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

Transportet e rastit janë shërbime që kryhen me autobus dhe përfshijnë:

a) **udhëtimet me dyer të mbyllura**, domethënë shërbimet e kryera me të njëjtin mjet që transporton një ose më shumë **grupe udhëtarësh të formuar më parë**, duke e kthyer çdo grup në vendin e nisjes;

b) shërbimet: i) e kryera për grupe udhëtarësh të formuara më parë, pa kthimin e udhëtarëve në vendin e nisjes gjatë të njëjtit udhëtim dhe kthimin bosh të mjetit në vendin e nisjes; ii) e kryera me mjet bosh në vajtje në vendin e destinacionit, për grupe udhëtarësh të formuara më parë, me kthimin e mjetit me udhëtarë në vendin e nisjes; c) shërbimet e organizuara me rastin e ngjarjeve të veçanta, si konferenca, seminare ose manifestime kulturore-sportive, që nuk u përgjigjen përkufizimeve të shkronjave "a" dhe "b".

Grup i formuar më parë do të quajmë një grup: a) për të cilin një organizëm ose një person përgjegjës është ngarkuar të marrë masa për nënshkrimin e kontratës ose për pagesën kolektive të shërbimit apo për marrjen e të gjitha prenotimeve dhe të pagesave përpara nisjes; b) që është formuar nga një numër personash: i) jo më pak se 12 veta; ii) jo më pak se 40 për qind e kapacitetit të mjetit, pa llogaritur shofer.

Ne nenin 3 “Përkufizime” të Udhëzimit të ministrit të Transportit dhe Infrastruktës nr.5627 datë 18.11.2016 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE BRENDA VENDIT”, i ndryshuar, ndër të tjera përcaktohet se: “Autoriteti i licencimit” është autoriteti përgjegjës qendror ose vendor, për lëshimin e licencave dhe certifikatave, sipas legjislacionit në fuqi dhe dispozitave të këtij udhëzimi.

“**Licencë**” është dokumenti, që i njeh titullarit të saj të drejtën për të kryer shërbime në transportin rrugor, për të tretë ose me qira të udhëtarëve brenda vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë udhëzim.

Ne VKM nr. 89, datë 14.02.2018 “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxenesve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studenteve” pika 2 “Fusha e zbatimit” parashikohet se:

2. Fusha e zbatimit

2.1. Transporti rrugor i nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe i studentëve me autobus.

2.2. Transporti rrugor i nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe i studentëve kryhet nëpërmjet shërbimit të rregullt të specializuar, operacioneve të transportit për llogari të vet **dhe shërbimeve të rastit**.

Ne VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve” pika 3 “Perkufizime” nder te tjera parashikohet se:

c) “Institucion arsimor parashkollor profesional parauniversitar dhe i lartë, publik apo privat”, institucioni sipas legjislacionit në fuqi për arsimin parashkollor, arsimin bazë, ku përfshihet arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët, arsimi i mesëm i lartë, profesional dhe arsimi i lartë, publik dhe privat.

ç) “Licencë”, akti administrativ i lëshuar për një periudhë të caktuar kohe, i vlefshëm për të ushtruar veprimtari transporti udhëtarësh.

dh) “Shërbimet e rregullta të specializuara”, shërbimet që sigurojnë transportin:

i) shtëpi – institucion parashkollor (kopshti i fëmijëve) dhe anasjelltas, sipas përcaktimeve të pikës 7.4, të kësaj rregulloreje;

ii) shtëpi – institucion shkollor ose universitet dhe anasjelltas, i parauniversitarëve dhe i studentëve, sipas përcaktimeve të pikës 7.4.

e) “**Shërbime transporti të rastit**”, ato shërbime transporti që nuk i përgjigjen përkufizimit të shërbimeve të rregullta të specializuara.

Në shërbimet e rastit nuk lejohet të lihen ose të merren gjatë udhëtimit nxënës ose studentë.

Këto shërbime kryhen për qëllime të aktivitetit edukativo-mësimor dhe argëtues të parauniversitarëve dhe të studentëve, jashtë qendrës urbane ku ndodhet institucioni i edukimit, shkollor apo universitar.

Ne VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve” pika 4 “Licenca dhe certifikata” nder te tjera parashikohet se:

4.1 Janë subjekt licencimi dhe certifikimi personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e transportit për: a) shërbimet e rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara për nxënësit e arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe

studentët; **b) shërbimet e rastit;** c) transportet për llogari të vet, të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve.

4.2 Licenca lëshohet në bazë të nenit 5, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, të ndryshuar.

4.3 Shërbimet e rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara **dhe shërbimet e rastit**, janë subjekt i licencës së lëshuar nga autoriteti kompetent sipas pikës 5, të kësaj rregulloreje.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë, në pronësi apo me qira, një autobus me minimalisht 55 vende të ulura për transportin e nxënësve, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi),
- certifikata e kontrollit teknik
- certifikatën e operimit të autobusit
- aktin e plotësimit të kushteve të komoditetit të autobusit
- policen e sigurimit të detyrueshem ku përfshihen:

a) sigurimi i përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete;

b) sigurimi i pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik.

Për mjetin e siguruar me qira (me ose pa drejtues mjete), dokumentet e mesipërme duhet të shoqerohen me kontratën perkatese të qirase, afati i së cilës duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 41, pika 4/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; ligjin 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar; ligjin 8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, i ndryshuar; Udhezimin e ministrit të Transportit dhe Infrastruktues nr.5627 date 18.11.2016 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE BRENDA VENDIT”, i ndryshuar; ligjin nr.32/2021 “Per sigurimin e detyrueshem ne sektorine transportit”; VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te

nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponojne nje autobus duke garantuar AK ne zbatimin e kontratës. Eshte kerkuar me 55 vende te ulura bazuar ne numrin e nxenesve te perzgjedhur per programin TUMO Tirana.

Ne nenin 77 te LPP nder te tjera parashikohet: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ne nenin 41 pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Ne nenin 54, pika 1/b te ligjit 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, percaktohet se:

1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Automjetet ndahen në:

b) Autobus: mjet i destinuar për transport njerëzish me më shumë se nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;

Ne nenin 83 “Dhënia me qira pa drejtues mjeti”, pika 1 dhe 2 te ligjit 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, percaktohet se:

1. Për zbatimin e këtij neni, një mjet quhet i caktuar për dhënie me qira pa drejtues mjeti kur qiradhënësi, kundrejt pagesës, detyrohet të verë në dispozicion të qiramarrësit, me kërkesën e këtij të fundit, vetë mjetin.

2. Mund të caktohen për dhënie me qira të gjitha mjetet me motor dhe rimorkiot e tyre, përfshirë edhe mjetet e caktuara për transportin e mallrave, me ngarkesë të plotë, e cila është mbi 1,5 ton, si dhe mjetet, të ndryshme nga autoveturat, të caktuara për transportin e njerëzve.

Ne nenin 84 “Shërbimi i qiradhënies me drejtues mjete për transportin e njerëzve”, pika 1 dhe 2 te ligjit 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, percaktohet se:

1. Shërbimi i marrjes me qira me drejtues mjete për transportin e njerëzve disiplinohet me aktet përkatëse.

2. Mund të destinohen për të kryer shërbimin e qiradhënies me drejtues mjete për transportin e njerëzve:

- motorët me kosh;
- autoveturat;
- autobuset;
- motomjetet dhe automjetet për transport të përzier ose për transport të veçantë njerëzish;
- mjetet e tërhequra nga kafshët.

Ne nenin 92, pika 1 te ligjit 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, percaktohet se:

1. Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Ne nenin 3 te ligjit 8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, i ndryshuar, pikat 3.5, 3.10, 3.11, 3.17 dhe 3.18 percaktohet se:

3.5. **Autobus:** mjet motorik i prodhuar vetëm për transportin e udhëtarëve me më shumë e 8 vende të ulura, përveç atij të drejtuesit të automjetit.

3.10. Transport i rregullt udhëtarësh është shërbim i rregullt transporti në itinerare dhe vendqëndrime të pandryshuara, të ofruara nga transportuesi dhe të përcaktuara më parë në rregulloren e udhëtimit. Ky shërbim mund të jetë qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, ndërkombëtar dhe shërbim i rregullt, i specializuar.

3.11. **Transport i rastit i udhëtarëve** nënkupton shërbimet që nuk përfshihen në shërbimet e rregullta brenda vendit ose ato ndërkombëtare, të perkufizuara në pikën 3.10 të nenit 3, të cilat kryhen në itinerarin, me çmimin, shkallën e shërbimit dhe kushtet e tjera, që përcaktohen në marrëveshjen ndërmjet transportuesit dhe përdoruesit.

3.17. Licencë: e drejta për të kryer veprimtari transporti të rregullt udhëtarësh dhe veprimtari transporti mallrash për të tretë e me qira brenda dhe jashtë vendit në përputhje me këtë ligj.

3.18. Certifikatë:

a) dokument që provon mbajtjen e licencës dhe është i vlefshëm për të drejtën e operimit të një mjeti.

Ne nenin 4 të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

Transportuesit që kryejnë veprimtari transporti në, nga dhe nëpër territorin tokësor të Republikës së Shqipërisë janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe:

- a) Të përdorin mjete transporti që kanë kaluar kontrollin e nevojshëm teknik.
- b) Të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrime e dokumente për çdo mjet dhe për veprimtarinë e vet transportuese, si dhe t'i ruajnë ato për 5 vjet nga data e transportimit.
- c) Të plotësojnë evidenca statistikore sipas formateve të miratuara nga organet përkatëse dhe t'i raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Përmbajtja, mënyra e regjistrimit, mënyra e raportimit dhe afatet përcaktohen në rregullore të posaçme të ministrit.

ç) Në mjet, gjatë qarkullimit, duhet të jenë dokumentet përkatëse sipas këtij ligji.

Ne nenin 5 të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të trete dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës.

Ne nenin 12 të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

Transporti i udhëtarëve brenda vendit kryhet nëpërmjet:

- a) shërbimeve në linjë të rregullta, transporti qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës;
- b) shërbimeve të rregullta, të specializuara;
- c) transporteve për llogari të vet;
- ç) transporteve të rastit.

Ne nenin 25 të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

Transportet e rastit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.11 të nenit 3, janë objekt i këtij ligji.

Ne nenin 26 te ligjit 8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, i ndryshuar, percaktohet se:

Transportet e rastit janë shërbime që kryhen me autobus dhe përfshijnë:

a) **udhëtimet me dyer të mbyllura**, domethënë shërbimet e kryera me të njëjtin mjet që transporton një ose më shumë **grupe udhëtarësh të formuar më parë**, duke e kthyer çdo grup në vendin e nisjes;

b) shërbimet: i) e kryera për grupe udhëtarësh të formuara më parë, pa kthimin e udhëtarëve në vendin e nisjes gjatë të njëjtit udhëtim dhe kthimin bosh të mjetit në vendin e nisjes; ii) e kryera me mjet bosh në vajtje në vendin e destinacionit, për grupe udhëtarësh të formuara më parë, me kthimin e mjetit me udhëtarë në vendin e nisjes; c) shërbimet e organizuara me rastin e ngjarjeve të veçanta, si konferenca, seminare ose manifestime kulturore-sportive, që nuk u përgjigjen përkufizimeve të shkronjave "a" dhe "b".

Grup i formuar më parë do të quajmë një grup: a) për të cilin një organizëm ose një person përgjegjës është ngarkuar të marrë masa për nënshkrimin e kontratës ose për pagesën kolektive të shërbimit apo për marrjen e të gjitha prenotimeve dhe të pagesave përpara nisjes; b) që është formuar nga një numër personash: i) jo më pak se 12 veta; ii) jo më pak se 40 për qind e kapacitetit të mjetit, pa llogaritur shofer.

Ne nenin 28 te ligjit 8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, i ndryshuar, percaktohet se:

Dokumentacioni, me të cilin duhet të jetë i pajisur autobusi në transportet e rastit, caktohet me udhëzim të ministrit.

Ne nenin 3 “Perkufizime” te Udhezimit te ministrit te Transportit dhe Infrastruktures nr.5627 date 18.11.2016 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN E LICENCEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE BRENDA VENDIT”, i ndryshuar, nder te tjera percaktohet se:

“Autoriteti i licencimit” është autoriteti përgjegjës qendror ose vendor, për lëshimin e licencave dhe certifikatave, sipas legjislacionit në fuqi dhe dispozitave të këtij udhëzimi.

“**Certifikatë operimi për transportin e udhëtarëve**” është dokumenti i lëshuar nga autoriteti i licencimit, që vërteton që mjeti është i autorizuar për transportin e udhëtarëve brenda vendit, sipas dispozitave të këtij udhëzimi;

“**Licencë**” është dokumenti, që i njuh titullarit të saj të drejtën për të kryer shërbime në transportin rrugor, për të tretë ose me qira të udhëtarëve brenda vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë udhëzim.

Ne nenin 9 “Perkufizime” te Udhezimit te ministrit te Transportit dhe Infrastruktures nr.5627 date 18.11.2016 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE BRENDA VENDIT”, i ndryshuar, nder te tjera percaktohet se:

1. Për marrjen e licencës në shërbimet e rregullta, të rregullta të specializuara dhe vajtje-ardhje të transportit të udhëtarëve brenda vendit, aplikanti paraqitet pranë autoritetit përkatës të licencimit, me dokumentacionin shoqërues të mëposhtëm:

1.2 Për mjetet, numrin e nevojshëm të kërkuar për shërbimin që do të operohet dhe për secilin mjet dokumentet si më poshtë:

a) Leja e qarkullimit;

b) Certifikata e kontrollit teknik të mjeteve;

c) Aktvlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit të mjeteve në transportin e udhëtarëve brenda vendit, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), sipas udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

d) Certifikata e kalibrimit të tahografit;

e) Regjistrimi i mjeteve në QKB.

1.5 Policë sigurimi se pronari/ përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili në transportin e udhëtarëve përfshin:

a) Sigurimin e udhëtarëve nga aksidentet në transportin publik;

b) Sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

Ne nenin 17 “Perkufizime” te Udhezimit te ministrit te Transportit dhe Infrastruktures nr.5627 date 18.11.2016 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE BRENDA VENDIT”, i ndryshuar, nder te tjera percaktohet se:

1. Certifikata për transportin e udhëtarëve lëshohet për çdo mjet pas plotësimit të kushteve sipas këtij udhëzimi dhe legjislacionit në fuqi, me paraqitjen e dokumentacionit për mjetin dhe për drejtuesin e tij sipas pikave 1.2 dhe 1.3, të nenit 9 të këtij udhëzimi.

Ne VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve” pika 2 “Fusha e zbatimit” parashikohet se:

2. Fusha e zbatimit

2.1. Transporti rrugor i nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe i studentëve me autobus.

2.2. Transporti rrugor i nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe i studentëve kryhet nëpërmjet shërbimit të rregullt të specializuar, operacioneve të transportit për llogari të vet **dhe shërbimeve të rastit**.

Ne VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve” pika 3 “Perkufizime” nder te tjera parashikohet se:

c) “Institucion arsimor parashkollor profesional parauniversitar dhe i lartë, publik apo privat”, institucioni sipas legjislacionit në fuqi për arsimin parashkollor, arsimin bazë, ku përfshihet arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët, arsimi i mesëm i lartë, profesional dhe arsimi i lartë, publik dhe privat.

ç) “Licencë”, akti administrativ i lëshuar për një periudhë të caktuar kohe, i vlefshëm për të ushtruar veprimtari transporti udhëtarësh.

d) “Certifikatë”, dokumenti që mbahet në mjet gjatë udhëtimit dhe që:

i) shoqëron licencën për rastet e transporteve rrugore që janë subjekt licencimi;

ii) i jep të drejtën një institucioni arsimor për transportin për llogari të vet të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve.

dh) “Shërbimet e rregullta të specializuara”, shërbimet që sigurojnë transportin:

i) shtëpi – institucion parashkollor (kopshti i fëmijëve) dhe anasjelltas, sipas përcaktimeve të pikës 7.4, të kësaj rregulloreje;

ii) shtëpi – institucion shkollor ose universitet dhe anasjelltas, i parauniversitarëve dhe i studentëve, sipas përcaktimeve të pikës 7.4.

e) “**Shërbime transporti të rastit**”, ato shërbime transporti që nuk i përgjigjen përkufizimit të shërbimeve të rregullta të specializuara.

Në shërbimet e rastit nuk lejohet të lihen ose të merren gjatë udhëtimit nxënës ose studentë.

Këto shërbime kryhen për qëllime të aktivitetit edukativo-mësimor dhe argëtues të parauniversitarëve dhe të studentëve, jashtë qendrës urbane ku ndodhet institucioni i edukimit, shkollor apo universitar.

Ne VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve” pika 4 “Licenca dhe certifikata” nder te tjera parashikohet se:

4.1 Janë subjekt licencimi dhe certifikimi personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e transportit për: a) shërbimet e rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara për nxënësit e arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe studentët; **b) shërbimet e rastit;** c) transportet për llogari të vet, të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe të studentëve.

4.2 Licenca lëshohet në bazë të nenit 5, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, të ndryshuar.

4.3 Shërbimet e rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara **dhe shërbimet e rastit**, janë subjekt i licencës së lëshuar nga autoriteti kompetent sipas pikës 5, të kësaj rregulloreje.

Ne VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve” pika 6. Kushtet që duhet të plotësojë mjeti i transportit nder te tjera parashikohet se:

6.1 Mjetet e transportit për shërbimin e rregullt dhe të rastit të transportit të institucioneve arsimore parashkollore, profesionale parauniversitare dhe universitare duhet, në çdo kohë, të jenë të pajisura me certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6.2 Mjetet e transportit për shërbimin e rregullt dhe të rastit të transportit të institucioneve arsimore parashkollore, profesionale parauniversitare dhe universitare duhet të jenë të pajisura me aktvlerësimin në plotësim të kushteve për komoditetin e autobusëve në transportin e udhëtarëve brenda vendit, të lëshuar në përputhje nenin 9, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, të ministrit, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

Ne udhezimin e Ministrisë se Punëve Publike dhe Transportit nr. 1649 date 16.08.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, i ndryshuar, percaktohet se: Mjetet motorike të transportit rrugor të udhëtarëve, janë të detyruar të kryejnë në kohë dhe me rezultat pozitiv kontrollin teknik të detyrueshëm, periodik dhe vjetor, në përputhje me udhë-zimin nr. 2, datë 11.3.2010, “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, të ndryshuar”. Gjithashtu, këto mjete rrugore,

gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duhet të plotësojnë dhe kushtet e tjera, që lidhen me sigurinë e udhëtarëve dhe komoditetin e udhëtimit të tyre, si me poshte:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një drejtues mjete, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin si mëposhtë:

- kontrata e punës e vlefshme;
- listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit;
- dokumentacionin që ka kryer/përfunduar të paktën arsimin e mesëm (diplomë apo vertetim);
- leje drejtimi ku të jetë e përfshirë një prej kategorive D1, D1E, D dhe DE;
- certifikatën e aftësisë profesionale përkatëse (CAP);
- vërtetim nga:
 - i) qendrat shëndetësore për mospërdorim të alkoolit, të lëndëve droguese ose psikotrope;
- Në rast se mjete është marrë me qira, OE duhet të paraqesë për drejtuesin e mjetit të gjithë dokumentacionin e lartpërmendur, por pa qenë e nevojshme që të figurojë në listëpagesën e OE.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 41, pika 4/b/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; ligjin 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, ligjin 8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, i ndryshuar; Udhezimin e ministrit të Transportit dhe Infrastruktues nr.5627 date 18.11.2016 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE BRENDA VENDIT”, i ndryshuar; ligjin nr.32/2021 “Per sigurimin e detyrueshem ne sektorine transportit”; VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve”; Udhezimin Nr. 3606/2, datë 28.10.2011 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “PËR PAJISJEN E DREJTUESVE TË MJETEVE RRUGORE TË KATEGORIVE C1, C, C1E CE, D1D, D1E DHE DE ME CERTIFIKATËN E AFTËSISË PROFESIONALE (CAP)”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponojnë një autobus duke garantuar AK në zbatimin e kontratës. Eshtë kërkuar me 55 vende të ulura bazuar në numrin e nxenesve të përzgjedhur për programin TUMO Tirana.

Ne nenin 77 te LPP nder te tjera parashikohet: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ne nenin 41 pika 4/b/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar parashikohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

Ne nenin 3 te ligjit 8308, date 18.03.1998 "Per transportet rrugore", i ndryshuar, pikat 3.5, 3.10, 3.11, 3.17 dhe 3.18 percaktohet se:

3.9. Drejtues i mjetit motorik: çdo shtetas që ka fituar shkallën e nevojshme të kualifikimit për drejtimin e një mjete motorik.

Ne nenin 84 "Shërbimi i qiradhënies me drejtues mjete për transportin e njerëzve", pika 1 dhe 2 te ligjit 8378 date 22.07.1998 "KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", i ndryshuar, percaktohet se:

1. Shërbimi i marrjes me qira me drejtues mjete për transportin e njerëzve disiplinohet me aktet përkatëse.

2. Mund të destinohen për të kryer shërbimin e qiradhënies me drejtues mjete për transportin e njerëzve:

- motorët me kosh;

- autoveturat;

- autobuset;

- motomjetet dhe automjetet për transport të përzier ose për transport të veçantë njerëzish;

- mjetet e tërhequra nga kafshët.

Ne nenin 115, pika 1 te ligjit 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, percaktohet se:

1. Ndalohet drejtimi i automjeteve dhe motomjeteve pa marrë lejedrejtimi, të parashikuar nga ky Kod.

Ne nenin 115/1, pika 3 dhe 6 te ligjit 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, percaktohet se:

3. Për drejtimin e mjeteve të shërbimit publik të linjave të pasagjerëve dhe të transportit të nxënësve të shkollave, drejtuesi duhet të jetë i pajisur me lejedrejtimi të njërës prej kategorive D1, D1E, D dhe DE.

6. Drejtuesit e mjeteve, mbajtës të lejedrejtimit të kategorive C1 ose C, C1E apo CE, e marrin certifikatën e aftësisë profesionale për transportin e mallrave dhe drejtuesit e mjeteve, titullarë të lejedrejtimit të kategorive D1, D1E, D dhe DE, e marrin certifikatën e aftësisë profesionale për transportin e pasagjerëve. Kjo e fundit është e nevojshme gjithmonë në rastin e transportit të nxënësve.

Ne nenin 178, pika 1, 3 dhe 5 te ligjit 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, percaktohet se:

1. Për të qarkulluar me mjete me motor, drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete këto dokumente:

a) lejeqarkullimin;

b) lejedrejtimi të vlefshëm për kategorinë përkatëse të mjetit;

c) autorizimin për ushtrimin e drejtimit të mjetit që i korrespondon kategorisë së mjetit për të cilin ushtrohet, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si dhe një dokument identifikimi;

ç) dokumentin që vërteton kontrollin teknik për mjetet e transportit rrugor;

d) certifikatën e sigurimit të detyruar.

3. Drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete edhe autorizimin ose lejen e transportit, kur mjete shfrytëzohet në një nga përdorimet e parashikuara në nenet 81 deri 84 të këtij Kodi.

5. Drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete certifikatën e aftësisë profesionale, kur ajo kërkohet.

Ne VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve” pika 7. Drejtuesi i mjetit nder te tjera parashikohet se:

7.1 Drejtuesi i mjetit të certifikuar për transport të rregullt të specializuar ose për llogari të vet, për nxënësit e arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe studentët duhet:

- a) të ketë kryer/përfunduar të paktën arsimin e mesëm;
- b) të jetë pajisur me leje drejtimi të kategorisë D1, D1E, D dhe DE;
- c) të jetë pajisur me certifikatën e aftësisë profesionale përkatëse (CAP);
- ç) të ketë reputacion dhe sjellje të mirë.

7.2 Për plotësimin e shkronjës “d”, të pikës 7.1, drejtuesi i mjetit duhet të vërtetojë reputacionin dhe sjelljen e tij të mirë me dokumente, si më poshtë:

a) trajnime për:

- i) kohën e drejtimit të mjetit dhe periudhat e pushimit të drejtuesve të mjeteve, kohën e punës (të detyrueshme për marrjen e certifikatës së aftësisë profesionale CAP);
- ii) rregullat e operimit në tregun e transportit të mallrave dhe të udhëtarëve (të detyrueshme për marrjen e certifikatës së aftësisë profesionale CAP);

b) vërtetime nga:

- i) qendrat shëndetësore për mospërdorim të alkoolit, të lëndëve droguese ose psikotrope;

Ne udhezimin Nr. 3606/2, datë 28.10.2011 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “PËR PAJISJEN E DREJTUESVE TË MJETEVE RRUGORE TË KATEGORIVE C1, C, C1E CE, D1D, D1E DHE DE ME CERTIFIKATËN E AFTËSISË PROFESIONALE (CAP)”, i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 4 përcaktohet:

Neni 2: Certifikata e aftësisë profesionale, e cila për efekt të përdorimit të shpeshtë në këtë udhëzim do të shënohet CAP, lëshohet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR-ja) dhe është një dokument që vërteton aftësimin profesional të përdoruesve të mjeteve rrugore që drejtohen me leje drejtimi të kategorive C1, C, C1E, CE, D1, D, D1E dhe DE, modeli i të cilës, pjesë e këtij udhëzimi, është i njëjtë me ato që parashikon direktiva e BE-së 2003/59/KE.

Neni 3: CAP është dokument personal, pjesë e dokumentacionit të qarkullimit të mjetit, evlefshme vetëm për përdorimin e mjeteve të përcaktuara në kategoritë e shënuara të cilat në të gjitha rastet duhet të jenë në përputhje me kategoritë e lejes së drejtimit të mbajtësit të saj.

Neni 4

CAP-et lëshohen në varësi të kërkesës dhe lejes së drejtimit të kandidatit dhe janë dy lloje:

- a) CAP për transportin e mallrave;

b) CAP për transportin e udhëtarëve.

Pajisen me CAP për transportin e mallrave drejtuesit e mjeteve që zotërojnë leje drejtimi të një prej kategorive C1, C1E, C dhe CE. Pajisen me CAP për transportin e udhëtarëve drejtuesit e mjeteve që zotërojnë leje drejtimi të një prej kategorive D1, D1E, D dhe DE.

II. Argumentimi i termave te references

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 15, pika 3/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Termat e references janë hartuar nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Termat e references, për shërbimin objekt prokurimi, përshkruajnë natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet, duke garantuar një shërbim të sigurt, cilesor dhe të vazhdueshëm në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ky prokurim ka për qëllim kontraktimin e një operatori ekonomik për realizimin e shërbimit të transportit të nxënësve të ciklit të mesëm, pjesëmarrës në programin TUMO Tirana. Te gjitha percaktimet e bera ne termat e references apo specifikimet teknike jane ne perputhje me natyrën, objektin dhe qëllimin e shërbimit të kerkuar si dhe bazohen ne legjislacionin e fushes per transportin e udhetareve dhe specifikisht ate te nxenesve, e konkretisht:

- ligjin nr. 8378, date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar;
- ligjin nr. 8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, i ndryshuar;
- ligjin nr.32/2021 “Per sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit”;
- VKM nr. 89, date 14.02.2018 “Per miratimin e kushteve dhe percaktimin e rregullave per transportin rrugor te nxenesve te arsimit parashkollor, profesional parauniversitar dhe te studenteve”;
- Udhezimit te ministrit te Transportit dhe Infrastruktures nr.5627 date 18.11.2016 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE BRENDIA VENDIT”, i ndryshuar.

Sa me siper, AK ka percaktuar llojin e transportit, i cili kategorizohet si “Shërbime transporti të rastit”, apo siç njihet shërbimi i transportit të rasti të udhëtarëve me “dyer të mbyllura”. Në shërbimet e rastit nuk lejohet të lihen ose të merren gjatë udhëtimit nxënës ose studentë. Këto shërbime kryhen për qëllime të aktivitetit edukativo-

mësimor dhe argëtues të parauniversitarëve dhe të studentëve, jashtë qendrës urbane ku ndodhet institucioni i edukimit, shkollor apo universitar. AK ka percaktuar edhe itinerarin, afatin e shërbimit, llojin dhe kushtet e mjetit apo edhe kërkesat e drejtuesit të mjetit.

NJESIA E PROKURIMIT